



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri
Mbledhja nr. 80/2016
Prishtinë, më 29.11.2016, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha – Shala, Blerim Grainca, Rrustem Berisha, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Sasha Milosavljeviç, zëvendëskryetar i dytë, dhe Fatmir Rexhepi, anëtar.

Pjesëmarrës të tjerë: Etleva Malushaj – LVV, Rinora Gojani – KOSID, Fjolla Uka – KDI dhe Amir Kozmaqi – INDEP.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11 dhe 15.11.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11 dhe 15.11.2016

Procesverbali i mbledhjes së datës 11 dhe 15.11.2016, u miratuan pa vërejtje.

Kryetari – Në kuadër të mbledhjes së 15 nëntorit 2016, vetëm të theksoj se të nesërmen, unë e kam parë një paralajmërim në media se atë ditë do të ketë ndërprerje të rrymës në 68 lokacione në Kosovë, për shkak të meremetimeve. Mua m'u ka dukur pak e dyshimtë ajo që në të gjitha ato lokacione, përnjëherë, të bëhet intervenimi dhe i kam bërë kërkesë ZRRE-së, që t'i vërtetojë këto intervenime. ZRRE-ja e ka bërë mbikëqyrjen dhe vërtetimin, dhe si rezultat i asaj, i ka bërë disa kërkesa që të ndërpritet ajo formë e ndërprerjes së rrymës dhe të vërtetohen të gjitha intervenimet. Mirëpo, kjo çështje, siç duket, ende nuk është rregulluar si duhet dhe ne tash presim raportim më të gjerë të ZRRE-së.

Rrustem Berisha – Sa i përket ndërprerjeve, sidomos në këto 7 komuna, edhe përkundër se ZRRE-ja ka lëshuar një vendim më datë 25.11.2016, që nuk ka mirëmbajtje, nuk ka ndërprerje, nuk ka ndërhyrje, prapë KEDS-i po vazhdon me këtë dhe është një shqetësim i madh i qytetarëve. Në fund, kërkoj që të marrim një sqarim, si Komision, lidhur me këtë vendim të ZRRE-së dhe zbatimin e tij nga KEDS-i.

Pas debatit, Komisioni vendosi:

Të kërkohet një informatë e shkurtër, lidhur me atë që të vërtetohet dhe të sqarohet situata më tutje, se çfarë ka ndërmarrë ZRRE-ja dhe çka po ndodh apo sa po zbatohet ky vendim nga KEDS-i.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale

Kryetari – Lidhur me këtë pikë të rendit ditës, tha se grupi i punës që një kohë të gjatë e ka bërë monitorimin e Ligjit për miniera dhe minerale dhe tani e ka përfunduar mbikëqyrjen, si dhe e ka përgatitur raportin final me rekomandime. Kryesuese e grupit të punës, është znj. Sala Berisha-Shala, të cilës ia dha fjalën për të paraqitur raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale.

Sala Berisha - Shala – Në emër të grupit të punës e prezantoi Raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale, si vijon: bazuar në mandatin e autorizuar nga Komisioni, grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, ka zhvilluar aktivitetet e nevojshme, me qëllim të mbledhjes së informatave dhe të dhënave mbi zbatimin e ligjit dhe ka arritur me sukses t'i përmbyllë aktivitetet e planifikuara në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Gjatë periudhës korrik – nëntor 2016, grupi i punës ka realizuar 1 dëgjim publik, 8 vizita në terren (më 19.7.2016 në KPMM, më 27.9.2016 në MZHE, më 28.9.2016 në KEK dhe në

Komunën e Obiliqit, më 3.10.2016, në Trepçë, më 20.10.2016, në Komunën e Drenasit dhe Ferronikel, më 26.10.2016, në MMPH dhe kompaninë “Peshter JLC”, më 4.11.2016, në Komunën e Pejës, Komunën e Deçanit, kompaninë “Qallaku”- Pejë, dhe kompaninë “Ndërtimi”- Pejë, më 9.11.2016, në Komunën e Kamenicës, në Kompaninë “Brickos”- Kamenicë dhe në kompaninë “GURI” SHPK- Gjilan) dhe ka mbajtur takime të grupit, qëllimi i të cilave ishte koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve. Në të gjitha fazat e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, grupi i punës është mbështetur nga stafi mbështetës i Komisionit, ku mbështetja e tyre ishte profesionale dhe teknike, të cilët i falënderoj për angazhimin. Qëllimet kryesore të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit janë: analiza dhe verifikimi i zbatimit të ligjit; efektet negative apo pozitive që mund të ketë sjellë zbatimi i ligjit; të shqyrtojë nëse efektet negative janë pasojë e dispozitave të ligjit, nga mënyra si është zbatuar ai apo të dyja bashkë; sfidat në zbatimin e ligjit; dhe, nxjerrjen e rekomandimeve që do të ndihmojnë në zgjidhjen apo përmirësimin e gjetjeve. Gjatë takimeve me institucione dhe grupe të interesit, jemi informuar se në përgjithësi, Ligji për miniera dhe minerale është në zbatim, por ka nevojë për koordinim të institucioneve dhe plotësim të ligjit. Grupi i punës, gjatë vizitave në terren dhe shqyrtimit të dhënave, ka arritur të gjejë, si vijon: Dispozitat e ligjit, në përgjithësi, janë të zbatueshme, megjithatë ende ka vështirësi në zbatim; ekziston mosharmonizim i ligjeve, të cilat ndërliken me ushtrimin e veprimtarisë minerare (Ligji për minierat dhe mineralet, Ligji për tokat bujqësore, Ligji për pyjet dhe Ligji për parqet nacionale); garancitë bankare për rikultivimin e tokës janë barrierë e rëndë për operatorët e veprimtarisë minerare; edhe më tutje ekzistojnë operimet ilegale në nxjerrjen e zhavorrit në lumenj dhe në afërsi të tyre dhe me pasojë tepër të mëdha për ambientin (sidomos shfaqja e vërshimeve, atje ku po degradohet shtrati i lumit); mospërfshirja e KPMM-së përkrah institucioneve tjera në Ligjin për faljen e borxheve publike, ka ndikuar negativisht te kompanitë të cilat nuk arrijnë të fshijnë obligimet që kanë ndaj KPMM-së; ka mungesë të koordinimit të mjaftueshëm mes institucioneve përgjegjëse në parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale; ka mungesë të dispozitave ligjore për hulumtimin dhe shfrytëzimin e hidrokarbureve të lëngëta dhe të gazta (naftës dhe gazit); nga veprimtaritë minerare, komunitetit i krijohen probleme të mëdha në lëvizje, në ambient, në jetën e banorëve dhe në çështje të tjera, por komuniteti nuk përfiton fare; marrja e lejeve dhe licencave është një proces i ndërlikuar, i stërzgatur dhe që kërkon shumë angazhim dhe shtrihet në shumë institucione; ka mungesë të koordinimit dhe të bashkëpunimit të mjaftueshëm në mes të institucioneve në lëshimin e lejeve dhe licencave; distancat e caktuara sipas ligjit nga objektet e ndryshme për lloje të caktuara të veprimtarisë minerare janë të mëdha, dhe po ashtu, janë në disharmoni me Ligjin e ujërave, sa u përket distancave nga lumenjtë; për ushtrimin e veprimtarisë minerare në disa zona, pengesë të madhe paraqet edhe Ligji për zonat e posaçme; mungon kompetenca e komunave për të vepruar në parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale; në periudhë të caktuar, operatorët në veprimtaritë minerare kanë mbetur pa licencë, për shkak të mungesës së Bordit të KPMM-së, organ i cili lëshon licenca; licencat u jepen operatorëve në sipërfaqe deri në 5 hektarë dhe jo më shumë (Ligji për pyje e kufizon sipërfaqen deri në 5 hektarë për një operator); masat ndëshkimore janë njësoj, edhe pse veprimtaritë minerare për nga vëllimi i punëve dhe kapacitetet financiare dallojnë, siç është rasti te operatorët me argjilë; qiraja për Agjencinë e Pyjeve është për tërë sipërfaqen që është marrë licenca, edhe pse resursi mineral shfrytëzohet gradualisht dhe kjo është barrierë për operatorët; shpronësimi i tokave për të cilat operatori nuk arrin të bëjë marrëveshje me pronarin e tokës, nuk po gjen zbatim (neni 33, paragrafi 2 i ligjit); nuk ka harmonizim të afateve të lejeve dhe licencave të lëshuara nga institucione të fushave ndryshme për të njëjtin operator; ekzistojnë

shumë lloje të taksave dhe kjo po paraqet sfidë për operatorët. Duke marrë parasysh gjitha këto të gjetura, grupi i punës ka nxjerrë këto rekomandime:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në afat prej afat 3 (tre) muajsh, të marrë nismën legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet, në çështjet si vijon: garancitë bankare, kthimin e një pjese të të hyrave nga tantemat në komunitet dhe përfitime tjera të komunitetit; rregullimi i nxjerrjes dhe shfrytëzimit të hidrokarbureve të lëngëta dhe të gazta (naftës dhe gazit), thjeshtësimin e lejeve dhe licencave, distancat nga objektet, krijimin e shërbimit “ONE STOP SHOP”, masat ndëshkimore;
2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afat prej 3 (tre) muajsh, të njoftojë Kuvendin se ka marrë masa për harmonizimin e ligjeve dhe akteve nënligjore, që ndërlidhen me ushtrimin e veprimtarisë minerare, si vijon:
 - 2.1. Ligji për tokën bujqësore (dispozitat që kanë të bëjnë me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore);
 - 2.2. Ligji për pyjet e Kosovës (dispozitat që kanë të bëjnë lidhur me përcaktimin e kohëzgjatjes së marrëveshjes për të drejtat pronësore dhe dispozitat lidhur më rikultivimin dhe rehabilitimin e zonës së minierës);
 - 2.3. Ligjet për parqet nacionale dhe zonat e mbrojtura (dispozitat që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtës për ushtrimin e veprimtarisë minerare në parqet nacionale dhe zonat e mbrojtura, si dhe të harmonizohet me Strategjinë Minerare);
 - 2.4. Ligji për ujërat e Kosovës (dispozitat që kanë të bëjnë me kufizimin e distancës nga lumenjtë);
3. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afat prej 3 (tre) muajsh, t’ia dorëzojë Kuvendit një analizë për mundësinë e përmbledhjes së shumë taksave në një taksë të vetme për operatorët minerarë;
4. KPMM-ja, në afat prej 3 (tre) muajsh, t’ia paraqesë Kuvendit një plan të veprimit për ndërmarrjen e masave për ndalimin e operimeve ilegale, dhe për të arritur këtë qëllim, të bashkëpunojë dhe koordinojë aktivitetet edhe me institucionet tjera përgjegjëse;
5. KPMM-ja, në afat prej 3 (tre) muajsh, t’i paraqesë Kuvendit një strategji për rritjen e efikasitetit për thjeshtësimin e dhënies së lejeve dhe licencave.

Në fund, tha se ka kërkuar nga KPMM-ja një informatë të shkurtër, se cilat ligje tjera janë në kolizion me zbatimin e Ligjit për miniera dhe minerale dhe që po iu krijojnë probleme operatorëve, që merren me veprimtarinë minerare. Po ashtu, kërkoi që të ndalohet nisma ligjore e propozuar nga një deputet, për plotësim-ndryshimin e ligjit në fjalë, në mënyrë që të bëhet harmonizimi i nismës ligjore, me të gjeturat faktike të grupit të punës gjatë mbikëqyrjes së ligjit në fjalë dhe me Komisionin funksional.

Kryetari – Kërkoi sqarime lidhur me dilemat që kanë disa kompani për licencat dhe lejet e operimit për hulumtim, që kalojnë dhe transferohen nga një operator tek një operator tjetër, sepse nuk e keni trajtuar këtë dukuri, se a është paraqitur nga ndonjë kompani ky shqetësim. Ndërsa, te çështja e rentës minerare të kthimit të një pjese të të hyrave nga tantemat në komunitet dhe përfitime tjera të komunitetit, të qartësohet në detaje sesi do të rregullohet kjo çështje. Po ashtu, kërkoi që kolizioni i përmendur me disa ligje tjera, të specifikohet qartë se në cilin nen është në disharmoni Ligji për miniera, me ato ligje.

Sala Berisha-Shala – Dha sqarime, sa i përket transferimit të licencave për hulumtime, të kalimit nga një operator tek tjetri dhe shtoi se gjatë monitorimit nuk kemi hasur këtë lloj problematike,

por një gjë e tillë është e rregulluar me ligj dhe KPMM-ja prapë e ka fjalën e fundit, se a e lejon apo jo.

Blerim Grainca – Sa i përket kalimit të licencave nga një operator te tjetri, kjo lejohet me Ligjin për miniera dhe minerale, por jo me automatizëm, por me marrëveshje në mes palëve.

Besim Beqaj – E përgëzoi grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale, që ka bërë një punë shumë të mirë në identifikimin e shumë problemeve që ka zbatimi i ligjit në praktik. Ndërsa, sa përket asaj se si kalohet një licencë nga një kompani tek tjetra, për këtë çështje duhet të kërkohet një informatë me shpjegim nga KPMM-ja, se si është e rregulluar kjo çështje dhe s’kemi nevojë të bëjmë rekomandim.

Enver Hoti – Lidhur me transferimin e licencave dhe lejeve për operim të kompanive që po lejohen të kalojnë nga një operator tek operatori tjetër, kjo çështje duhet sqarohet dhe të trajtohet më seriozisht, pasi që për këto palë ka dyshime që bëjnë këtë formë të transferimit dhe për këtë çështje duhet të kërkohet raport më i detajuar nga KPMM-ja, se si i zbaton procedurat transferimit.

Raif Qela – Të nderuar deputetë, lidhur me kalimin e licencave, pas përgjigjes që do ta marrim nga KPMM-ja, kemi mundësi që shqetësimet, nëse janë të arsyeshme, nëse ka mundësi që ato licenca të shfrytëzohen qoftë edhe për të krijuar beneficione, në krahasim me të tjerat, mund t’i inkorporojmë në nismën ligjore, të cilën po mendojmë që do ta nisë, pikërisht ky Komision. Dhe këtë, edhe nëse nuk e trajtojmë sot, në këto rekomandime mund t’i shtrojmë më vonë si çështje e nismës ligjore. Ndërsa, një çështje tjetër, që do ta trajtoj, është nisma ligjore që është ndërmarrë prej deputetit, megjithëse ai ka qenë i njoftuar se në jemi në procedurë e sipër edhe për çështjen për të cilën ai e ka ngritur. Çështja që është lidhur me rentën minerare, është trajtuar edhe në nismën ligjore për Obiliqin, që tani është projektligj, për shkak se ka pasur pengesa në Ligjin për miniera dhe minerale, sepse nuk ka qenë i precizuar saktë, ndërsa në një farë mënyre, nga Qeveria ka ardhur përgjigje se ky projektligj nuk mund të kalojë, për shkak të kolizionit me një ligj ndër më të rëndësishmit në vend, Ligjit mbi financat publike dhe përgjegjësitë. Pikërisht, për këtë shkak, edhe është ndaluar për një kohë vazhdimi i procedimit të mëtutjeshëm të projektligjit. Meqenëse Ligji për Trepçën, që është miratuar kohëve të fundit, e precizon saktë që renta minerare prej 20% i ndahet komunitetit, është krijuar precedent dhe tani edhe me Projektligjin për Obiliqin do të veprohet në të njëjtën mënyrë dhe që të dyja këto bashkë nga ana e Qeverisë është interpretuar se bien në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Ka mundësi që edhe tani të thonë ashtu, në nenin 2.6 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ku thuhet: “përgjashtimisht, nëse një dispozitë e një ligji ose rregullore e UNMIK-ut krijon ose autorizon krijimin e ndonjë fondi të veçantë ose ndonjë fondi për qëllim të caktuar për çfarëdo artikulli të parasë publike, ky fond duhet të krijohet në formë të llogarisë së ndarë ose të llogarisë, në kuadër të fondit të konsoliduar të Kosovës, dhe paratë publike, të cilat mbahen në këtë llogari, i nënshtrohen plotësisht paragrafit 3 të këtij neni, dispozitat me aktet ligjore ose nënligjore, përveç një ligji ose rregullore të UNMIK-ut, që krijojnë ose autorizojnë krijimin e një fondi të tillë, janë të paligjshme dhe nuk prodhojnë efekte juridike”. Ky nen nuk është i qartë dhe si pasojë e kësaj ka ardhur deri te përgjigjja prej ministrisë, për Ligjin për Obiliqin, respektivisht edhe tash mund të thonë edhe për Ligjin për Trepçën, se bie në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Përderisa në Ligjin

për Trepçën është precizuar që 20% duhet t'i shkojë komunitetit dhe është precizuar që kjo i hap rrugë, që të krijohet një llogari e ndarë ose nënlllogari, në kuadër të fondit të Kosovës, që të mos e interpretojnë në kundërshtim me ligjin, ndoshta është e udhës që pasi e kanë interpretuar ashtu edhe herën e parë në Ligjin për Obiliqin dhe mund ta interpretojnë tani edhe në Ligjin për Trepçën, përderisa ka mundësi që për këto të dyja, këto ligje themi se nuk mund të ndahen edhe të përfitohet në kohë edhe disa muaj apo vite është mirë që ne të kërkojmë interpretim ligjor të këtij neni, në mënyrë që edhe kjo t'ia hap rrugën që renta minerare të ndahet prej tani, e jo të mbetet që edhe një herë të rishqyrtohet ligji, pasi që të shihet që kjo është në kolizion.

Besim Beqaj – E paraqiti nenin 10 të Ligjit për miniera dhe minerale, që ka të bëjë me transferimin dhe lënien peng të licencave dhe lejeve. Pra, lidhur me këto dilema që u cekën, tha se neni 10 është shumë i qartë, andaj, vetëm duhet të kërkohej zbatimi nga KPMM-ja. Sa i përket rentës minerare, lidhur me kthimin e një pjese të të hyrave nga tantimat në komunitet dhe përfitime tjera të komunitetit, theksoi se në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike, duhet vetëm të krijohet një kod buxhetor dhe mjetet duhet të mblidhen për destinim, se përndryshe Ligji për menaxhimin e financave publike nuk e lejon krijimin e fondeve.

Rrustem Berisha – Në cilësinë e anëtarit të grupit të punës, theksoi se vizitën që ia bëmë KEK-ut, ishte alarmante. Sipas përfaqësuesve të KEK-ut, problem ishte se në disa fshatra, në Hadë dhe Shipitullë, ishin ende duke u ndërtuar shtëpi, ndërsa për këto ndërtime të shtëpive, banorët e këtyre fshatarëve po kërkojnë kompensim. Në këtë rast, përfaqësuesit e KEK-ut, lidhur me këtë problematikë, thanë se nuk kanë gjetur mirëkuptim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Financave, që janë përgjegjës për këtë çështje. Kjo do të thotë se nuk kishte bashkëveprim me kohë në mes të këtyre institucioneve, për t'i parandaluar këto ndërtime të shtëpive, pasi në ato zona parashihet të shtrihet mihja sipërfaqësore e KEK-ut, andaj lidhur me këtë problematikë, duhet t'i gjendet një zgjidhje KEK-ut.

Duda Balje – Lidhur me shpronësimet e pronave në fshatrat Hadë dhe Shipitullë, që i ngriti kolegu Berisha, tha se me këtë çështje është duke u marrë edhe Komisioni për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ku ajo është kryetare dhe potencoi se iu ka drejtuar Qeverisë me kërkesë, që t'iu gjendet zgjidhje këtyre banorëve për kompensimin e shtëpive dhe shpronësimin e pronave. Qeveria na ka njoftuar se ka marrë vendim për fshatin Shipitullë, që të fillojë me procedurat e kompensimit, ndërsa për Fshatin Hadë ende nuk është marrë vendim. Ne, si Komision, jemi duke i përgatitur rekomandimet lidhur me këtë çështje, ndërsa ky ligj nuk e rregullon këtë çështje.

Rrustem Berisha – Kjo çështje mund të gjejë zgjidhje, nëse ka bashkëpunim të mirëfilltë në mes institucioneve.

Besim Beqaj – Lidhur me çështjen e shpronësimit të zonave për mihje të KEK-ut, tha se këto janë të ndërlidhura me Bankën Botërore, ku pritet të ndërtohet Termocentrali “Kosova e Re”, ndërsa sa i përket ndërtimit të shtëpive në ato zona, Banka Botërore e ka bërë vlerësimin dhe ka caktuar datën, deri kur duhet të bëhet shpronësimi.

Sala Berisha- Shala – Propozoj që për çështjen e shpronësimit, që e ngritën kolegët deputetë, mund ta plotësojmë rekomandimin e parë.

Kryetari – Rekomandimin e parë mund ta plotësojmë edhe me propozimin se të gjitha nismat ligjore për plotësim-ndryshimin e Ligjit për miniera dhe minerale, duhet të kenë harmonizim të përbashkët në mes deputetëve dhe Komisionit funksional. Propozoj që të kërkohet një informatë nga KPMM-ja, lidhur me ecurinë e proceduarave të përcaktuara sipas nenit 10 të ligjit “Transferimi dhe lënia peng e licencave dhe lejeve”, sesi janë duke e zbatuar këtë dispozitë.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

I. Miratohet Raporti me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158.

II. Rekomandime

- 1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në afat prej afat 3 (tre) muajsh, të marrë nismën legislative për ndryshimin e Ligjit për minierat dhe mineralet, në çështjet si vijon: garancitë bankare, kthimin e një pjese të të hyrave nga taniemmat në komunitet dhe përfitime tjera të komunitetit; rregullimi i nxjerrjes dhe shfrytëzimit të hidrokarbureve të lëngëta dhe të gazta (naftës dhe gazit), thjeshtësimin e lejeve dhe licencave, distancat nga objektet, krijimin e shërbimit “ONE STOP SHOP”, çështjen e shpronësimit në zonat minerare, masat ndëshkimore, si dhe të gjitha nismat ligjore, të ndërmarra në Kuvend, të përfshihen në një projekt të vetëm, hartimi i Ligjit të ri për minierat dhe mineralet.*
- 2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afat prej 3 (tre) muajsh, të njoftojë Kuvendin se ka marrë masa për harmonizimin e ligjeve dhe akteve nënligjore, që ndërlidhen me ushtrimin e veprimtarisë minerare, si vijon:*
 - a. Ligji për tokën bujqësore (dispozitat që kanë të bëjnë me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore dhe dispozitat që kanë të bëjnë me dhënien e tokës publike me qira, shih neni 11 i këtij ligji, si dhe UA nr.41/2006 dhe nr.10/2010);*
 - b. Ligji për Pyjet e Kosovës (dispozitat që kanë të bëjnë lidhur me mospërcaktimin e kohëzgjatjes së marrëveshjes për të drejtat pronësore dhe dispozitat lidhur me rikultivimin dhe rehabilitimin e zonës së minierës, shih neni 5, 6 dhe 27 i këtij ligji);*
 - c. Ligjet për parqet nacionale dhe zonat e mbrojtura (këto ligje duhet të harmonizohen me Strategjinë Minerare 2012-2025);*
 - d. Ligji për ujërat e Kosovës (dispozitat që kanë të bëjnë me kufizimin e distancës nga lumenjtë, shih neni 48 i këtij ligji).*
- 3. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afat prej 3 (tre) muajsh, t’ia dorëzojë Kuvendit një analizë për mundësinë e përmbledhjes së shumë taksave në një taksë të vetme për operatorët minerarë.*
- 4. KPMM-ja, në afat prej 3 (tre) muajsh, t’ia paraqesë Kuvendit një plan të veprimit për ndërmarrjen e masave për ndalimin e operimeve ilegale, dhe për të arritur këtë qëllim, të bashkëpunojë dhe koordinojë aktivitetet edhe me institucionet tjera përgjegjëse.*

5. *KPMM-ja, në afat prej 3 (tre) muajsh, t'i paraqesë Kuvendit një strategji për rritjen e efikasitetit për thjeshtësimin e dhënies së lejeve dhe licencave.*

III. Arsyetimin lidhur me këtë Raport me rekomandime e paraqet deputetja Sala Berisha - Shala, anëtare e Komisionit.

4. Të ndryshme

Kryetari e njoftoi Komisionin se përfaqësuesit e Bankës Botërore kanë kërkuar një takim me Komisionin, lidhur me procesin përgatitor për strategjinë e re të partneritetit me Kosovën, për periudhën që mbulon vitet fiskale 2017-2021 dhe propozoi që ky takim të mbahet, pas mbledhjes së radhës së Komisionit, më datë 6.12.2016.

Me këtë propozim të kryetarit, u pajtua Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa